**VENDIM**
**Nr. 406, datë 4.7.2018**

# PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E BRENDSHME TE MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË TË PJESËVE TAKUESE TË PRONËS ME EMËRTIMIN "GARDA E REPUBLIKËS, GARNIZON", ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE NR. 8270, ME NUMËR PASURIE 4/134, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 815, DATË 29.11.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SHTESË TË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BRENDSHME, PËR GARDËN E REPUBLIKËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Brendshme te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të sipërfaqes 21 229 $m^2$, nga të cilat 2 853 $m^2$ ndërtesë, pjesë e pronës me emërtimin "Garda e Republikës, Garnizon", me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8270, me numër pasurie 4/134, sipas hartës treguese dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të sipërfaqes 25 004,3 $m^2$, nga të cilat 2 021 $m^2$ ndërtesë, pjesë e pronës me emërtimin "Garda e Republikës, Garnizon" me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8270, me numër pasurie 4/134, për realizimin e projektit "Për hyrjen e parkut", sipas hartës treguese, planimetrisë dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Prona me emërtimin "Garda e Republikës, Garnizon", me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 8270, me numër pasurie 4/134, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi, hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 815, datë 29.11.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

4. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Tiranë dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**


ZONA KADASTRALE 8270
NR. I PASURISE: 4/134 VOL 60 FQ 210
INDEKSI I HARTES TR-T-11, U-11 SHKALLA 1:1000
ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANE Q/F Tirane
Rr.: DORA D'ISTRIA
S1=21.229 m2 - Ministria e Financave dhe Ekonomise
S1=25.004,5 m2- Bashkia Tirane
Objekte
S1
S2
4/134
TR; U-11

# Planvendosje

ZONA KADASTRALE 8270

NR. I PASURISE: 4/134 VOL.60 FQ.210

INDEKSI I HARTES: TR-T-11; U-11 SHKALLA: 1:1000

ADRESA E PASURISE: Rrethi TIRANE Q/F Tirane

Rr/L: DORA D'ISTRIA

S1=21.229 m2 - Ministria e Financave dhe Ekonomise

S1=25.004,3 m2- Bashkia Tirane

Objektet



1. FORMULARI PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUJTËSHME SHTETËRORE
( Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta )

Institucioni I Pushtetit Vendor
MPB ( Garda e Republikës )
Bashkia Tiranë
Fusha e Përdorimit të Pronës
Ruajtje Personaliteteve Shtetërore dhe ORV.

Identifikoi: Ing. Altin Arapi nr. Lic. N 6486/4

| NR | A | | | B | | | | C | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zona Kadast indeksi hartës | Nr. Pasurive | Emërtesa e pronës Vendodhja | Komponen. Përbërëse të Pronës | Sipërfaqja totale e pronës m² | Nga sip. totale sa ndërtesa m² | Funksioni për të cilin përdoret prona | Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative | Institucioni/Enti përdorues statusi juridik i pronës | Të dhëna të tjera shënime të veçanta |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| | | | Garda e Republikës | | | | | | | |
| 3 | 8270 | | Garnizon | | 46206.4 | 5437.4 | | | | ndryshim në metra |
| | | | | S. 1 Godin | | 120 | Postoblloku | MPB | Garda e Republikës | Një kat tullë |
| | | | | S. 2 Godin | | 938.5 | Njësia e Dytë | MPB | Garda e Republikës | Dy kat tullë |
| | | | | S. 3 Godin | | 1301.2 | Njësia e Parë | MPB | Garda e Republikës | Katër kat tullë |
| | | | | S. 4 Godin | | 230 | Garazhe | MPB | Garda e Republikës | Një kat tullë |
| | | | | S. 5 Godin | | 117 | Garazhet vkt | MPB | Garda e Republikës | Një kat tullë |
| | | | | S. 6 Godin | | 182 | Lavzhi mjeteve | MPB | Garda e Republikës | Një kat tullë |
| | | | | S. 7 Godin | | 358.4 | Zyra, fjetore | MPB | Garda e Republikës | Dhënë me U.Ministri |
| | | | | S. 8 Godin | | 279 | Zyra, fjetore | MPB | Garda e Republikës | Dhënë me U.Ministri |
| | | | | S. 9 Godin | | 344.5 | Depo, ofiçinë | MPB | Garda e Republikës | Një kat tullë |
| | | | | S. 10 Godin | | 925 | Garazh,gomist | MPB | Garda e Republikës | Një kat tullë |
| | | | | S. 11 Godin | | 475 | Dushe,depo karb. | MPB | Garda e Republikës | Një kat tullë |
| | | | | S. 12 Godin | | 83.5 | Depo armatimi | MPB | Garda e Republikës | Një kat tullë |
| | | | | S. 13 Godin | | 83.5 | Depo armatimi | MPB | Garda e Republikës | Një kat tullë |
| | | | | Tunel | | | Tunelet | MPB | Garda e Republikës | Beton arme |
| | Shënim | | Trull Funksional | | 40769 | | | | | |
| | | | Sip. Ndërtimore | | | 5437.4 | | | | |

Miratuar nga V. K. M. Nr. 519, Date 7.11.1991

# KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol 60 Fq 210

## A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale: 8270 NR i PASURISE: 4/134

→ Vijon nga Vol ____ Fq ____

Indeksi i Hartes: TR-T-11;U-11

Vijon ne Vol ____ Fq ____ deri ne Vol ____ Fq ____ →

Adresa e Pasurisë: Rrethi Tirane Q/F Tirane

PERFUNDIMTARE (data): 25/11/2010

Rr/L DORA D'ISTRIA P/G SH ___ K ___ Ap ___

Përshkrim i veçante

GARDA E REPUBLIKES
SIPAS REF. NR 23128 DATE 25.08.2011
BEHET NDRYSHIMI I SIPERFAQEVE NE
RRESHTIN E DYTE TE REFERENCAVE

## B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurise: TRUALL Brenda V.K.N. ____ Ref ____

| Sip. Totale e Pasurise | Nga Sip. Totale sa Trual | Nga Sip. Truall sa Ndertesi |
|---|---|---|
| 1 46,514.00 m² Ref LN 2009 | 1 46,514.00 m² Ref LN 2009 | 1 5,154.00 m² Ref LN 2009 |
| 2 46,233.30 m² Ref LN 2009 | 2 46,233.30 m² Ref LN 2009 | 2 4,874.00 m² Ref LN 2009 |
| 3 ____ m² Ref ____ | 3 ____ m² Ref ____ | 3 ____ m² Ref ____ |
| 4 ____ m² Ref ____ | 4 ____ m² Ref ____ | 4 ____ m² Ref ____ |

Per pjesen e përbashket
PALLAT
Kuota e pjesmarrjes ____ %
Nr i Pasurise (pallat) ____
Vol ____ Faqe ____

## C - SEKSIONI I PRONESISE

| Nr Dok | Data Regjistrimit | Emri | Atesia | Mbiemri | Nr Pasap | I/F/B | Adresa e Pronarit | Shuma e Paguar | Data e Lesh. Certifikates | Shenime | Firma |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| LN 2009 | 30/09/2009 | SHTET | | | | I | PESHKOPI Rruga SLLOVE | | | | |

Shenim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik, F - perfaqesues i familjes, B - bashkepronar [illegible]

# HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

*(Fragment)*

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUEJTSHME
TIRANË

REGJISTRUES

Elion Semanaj

Vula/Firma

**A. IDENTIFIKIMI I PASURISE**

ZONA KADASTRALE 8270
NR. I PASURISE 4/134 VOL 60 FQ 210
INDEKSI HARTES TR-T-11;U-11 SHKALLA 1:2500
ADRESA E PASURISE. Rrethi Tirane Q/F Tirane
Rr/L DORA D'ISTRIA P/G SH K ___ Ap

**B. KUFIZIMET**

V ______________
L ______________
J ______________
P ______________

**C. PRONARI**

SHET

D. Data: 26/06/2018 Ora 1:11:19PM

